



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
KUÇOVË

Nr. 456 Prot.

Kuçovë, më 06.02. 2024

VENDIM

Nr. 6, datë 30/01/2024

“Për miratimin e një ndryshimi të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.14 datë 25.02.2021 mbi miratimin e dhënies së ndihmës financiare për Z. Asqeri Shuaipi për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore”.

Këshilli Bashkiak, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Sektori i Investimeve, Pronave dhe Emergjencave Civile, mbështetur në ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile” si dhe në V.K.M – në nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 263 datë 24.05.2013 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, mbështetur në shkresën nr.955/3 Prot. datë 14.12.2023 nga Këshilli i Qarkut Berat për rivlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i vitit 2014 e në vazhdim për qytetarin Asqeri Shuaipi,

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare për Z. Asqeri Shuaipi, për Përballimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësi Natyrore, me vlerën 708 667 lekë , ku në zbatim të V.K.M – së Nr.329 datë 16.05.2012 të sipërpërmendur do të dëmshpërblehen me 50% të shumës së preventivit, me 354 333.5 (*treqind e pesdhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë.



2. Miratimin e ndryshimit të vlerës së miratuar të Vendimit të Këshillit Bashkiak numër 14 të datës 25.02.2021 për Z. Asqeri Shuaipi.
3. Ngarkohet Sektori i Investimeve, Pronave dhe Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Ky vendim u miratua 23 vota pro; 1 kundër;
1 abstenim; 23 këshilltaret prezent

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

ALEKSANDËR ZIU

